

Behxhet DIBRANI

Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”,

Fakulteti Filozofik, Departamenti “Histori”

Email: bdibrani@hotmail.com

ORCID: <https://orcid.org/0009-0006-9301-9596>

KUD: 94(496.51)“2004”(05)

&

Arben BERISHA

Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”,

Fakulteti Filozofik, Departamenti “Histori

Email: arben.berisha9@student.uni-pr.edu

ORCID: <https://orcid.org/0009-0002-5754-6736>

KUD: 94(496.51)“2004”(05)

TRAZIRAT E VITIT 2004 NË KOSOVË: NDIKIMI I TYRE RRETH FILLIMIT TË BISEDIMEVE PËR STATUSIN E KOSOVËS

Abstrakt:

Ky hulumtim ka të bëjë me situatën e përgjithshme në Kosovë gjatë administrimit ndërkombëtar, me fokus të veçantë trazirat e marsit të vitit 2004 në Kosovë dhe pasojat dhe efektet e këtyre zhvillimeve në procesin e statusit të Kosovës. Përmes konsultimit të dokumenteve, raporteve dhe literaturës mund të krijohet një pasqyrë më e qartë e efekteve që prodhuan këto trazira në procesin e fillimit të bisedimeve për statusin e Kosovës. Shihet qartë që deri te një situatë e tillë eskaluese kishin sjellë shumë rrethana sociale, politike dhe ekonomike. Një nga faktorët që kishte ndikuar në fillimin e trazirave, që ishte konstatuar nga shumë ekspertë politikë, ishte gabimi që kishte bërë administrata e përkohshme ndërkombëtare e OKB-së në Kosovë, që nuk kishte qartësuar statusin e ardhshëm të Kosovës. Mosqartësimi i statusit të ardhshëm të Kosovës kishte filluar të shkaktonte shqetësime dhe frustrime te popullata vendore. sidomos tek ajo shqiptare. Prandaj mjaftonte një shkëndijë e vogël që situata të shpërthente. Një incident eskalues, i cili u përhap shumë shpejt, ndodhi me mbyrtjen e tre fëmijëve shqiptarë në lumin Ibër në Mitrovicë. Zgjerimi shumë i shpejtë i demonstratave në Kosovë në vitin 2004 ishte një

tregues i qartë se sa e brishtë ishte situata politike, sociale dhe ekonomike në Kosovë, andaj kjo bëri që faktori ndërkombëtar, sidomos OKB-ja, të fillonte të merrej shumë më seriozisht me procesin e hapjes së bisedimeve për statusin e Kosovës. Edhe pse këto trazira dëmtuan reputacionin ndërkombëtar të Kosovës, një fakt i pamohueshëm është se u përshpejtua hapja e bisedimeve rreth statusit të Kosovës që ishte një vendim i duhur dhe nuk mund të shtyhej më tutje çështja e statusit politik të Kosovës. Me këtë konstatim ishin pajtuar edhe shumë diplomatë ndërkombëtarë si: Holbrooke, Kai Eide, Martti Ahtisaari, prandaj pas një viti, në vitin 2005 edhe filluan përgatitjet duke u krijuar ekipi negociator që do të përfaqësonte Kosovën në bisedimet e Vjenës. Trazirat e marsit të vitit 2004 ishin një sinjal se status quo-ja nuk mund të vazhdonte më tej nga administrata e përkohshme e OKB-së në Kosovë.

Fjalë kyçe: UNMIK, UÇK, KFOR, Trazirat e marsit.

Abstract:

This research deals with the overall situation in Kosovo during the period of international administration, with particular focus on the March 2004 unrest in Kosovo and the consequences and effects of these developments on the Kosovo status process. By consulting documents, reports, and literature, a clearer overview can be created of the effects these disturbances had on the initiation of negotiations regarding Kosovo's status. It is evident that such an escalatory situation was the result of numerous social, political, and economic circumstances. One of the factors that contributed to the outbreak of the unrest, as noted by many political experts, was the error made by the UN Interim Administration in Kosovo, which had failed to clarify Kosovo's future status. The lack of clarity regarding Kosovo's future began to generate concern and frustration among the local population, particularly among Albanians. Thus, even a small spark was enough for the situation to erupt. An incident that quickly escalated occurred with the drowning of three Albanian children in the Ibar River in Mitrovica. The rapid escalation of the demonstrations in Kosovo in 2004 was a clear indicator of how fragile the political, social, and economic situation in Kosovo was. This prompted the international factor, especially the UN, to take the process of initiating negotiations on Kosovo's status much more seriously. Although these disturbances damaged Kosovo's international reputation, an undeniable fact is that they accelerated the opening of talks regarding Kosovo's status - a necessary decision that could

no longer be postponed. Many international diplomats, including Holbrooke, Kai Eide, and Martti Ahtisaari, agreed with this assessment. Consequently, in 2005, preparations began with the formation of the negotiating team that would represent Kosovo in the Vienna talks. The March 2004 unrest was a clear signal that the status quo could no longer be maintained by the UN Interim Administration in Kosovo.

Keywords: UNMIK, KLA, KFOR, March unrest.

Vështrim teorik mbi shtetndërtimin dhe komponentët e tij

Sot në literaturën moderne mund të hasim në konceptime të ndryshme rreth definicionit për shtetndërtimin. Studiuës të ndryshëm kanë mendime të ndryshme, disa e quajnë termin shtetndërtim ndërkombëtar, disa shtetndërtim eksternal, disa shtetndërtim nga ndërhyrjet, në esencë të gjitha këto kanë një ide të përbashkët. ¹ Definimi i shtetndërtimit është një diskutim që edhe sot e kësaj dite nuk ka një qëndrim unik rreth definicionit dhe përkufizimeve se çfarë është shtetndërtimi dhe çfarë përfshin ai. Shtetet shihen si një model dominues i organizimit të shoqërive sot. Ndërtimi i shtetit është një proces përmes të cilit shtetet rrisin aftësinë e tyre për të funksionuar: pra, qëllimi është funksionaliteti². Edhe sot ndërtimi i shtetit konsiderohet si një proces kombëtar dhe produkt i marrëdhënieve në mes shtetit dhe shoqërisë i cili mund të ndikohet nga një mori forcash të jashtme, por përfundimisht formësohet nga zhvillimet lokale³.

Për të kuptuar më mirë vendosjen e administrimeve ndërkombëtare në botë, duhet të trajtohen strategjitë që ishin përdorur në procesin e shtetndërtimit. Sot, në botën akademike ende nuk ekziston një standard që mund të konsiderohet si standard universal dhe i aplikueshëm në administrimet territoriale të OKB-së në vende të ndryshme⁴.

¹ Bashota, *Teoria dhe Praktika e Administrimit Territorial Ndërkombëtar*, (Shkup, 2018), 218.

² Alan Whaites, "States in Development: Understanding State-building- Governance and Social Development", Group Policy and Research Division, *A DFID WORKING PAPER*, 2008, p.4. <https://gsdrc.org/document-library/states-in-development-understand>, qasur më 25.12.2023

³ Po aty, p.4

⁴ Bashota, *Teoria dhe Praktika*, 286.

Kur themi këtë duhet kemi parasysh se ende nuk ka një standard që do të mund të përdorej si universal për të gjitha misionet ndërkombëtare në botë, sepse secili rast në botë ka specifikat e veta, dhe kjo ka bërë që të aplikohen edhe qasje të ndryshme nga OKB-ja me vendosjen e administrimeve territoriale në përputhje me specifikat e shoqërisë dhe vendit ku është vendosur administrimi ndërkombëtar. Në periudhën pas Luftës së Ftohtë vërehet një tendencë nga administrimet territoriale të OKB-së, në vendet ku vendosen, synojnë të kenë kompetenca sa më të mëdha dhe ndërhyrje sa më të drejtpërdrejta. Një shembull i tillë është rasti i kryeadministratorit në Bosnje por edhe në Kosovë⁵. Shembuj konkret të angazhimeve ndërkombëtare të OKB-së, përmes krijimit të strukturave krejtësisht të reja politike kemi pasur në Timorin Lindor, Bosnje dhe në Kosovë. Pra, nuk ka pasur vetëm asistencë teknike, por një angazhim të thellë, i fokusuar në ndërtimin e institucioneve demokratike.

Për shtetndërtuesit ndërkombëtarë, qëllimi kryesor ishte ndërtimi i strukturave sa më racionale shtetërore, përfshirë strukturat sociale dhe ekonomike, si dhe rritja e efikasitetit institucional. Fokusi ishte parandalimi i rikthimit të konfliktit eventual në vendin ku ishin vendosur administratorët ndërkombëtarë. Megjithëse, një strategji e tillë jo gjithmonë u pëlqente partive politike vendase. Përkundër se nuk ekziston një konsensus i përbashkët rreth kësaj çështje, mund të themi që në dekadat e fundit të administrimeve territoriale ndërkombëtare të OKB-të, mund të vërehet një strategji shtetndërtuese, fillimisht liberalizimi i shoqërisë e pastaj institucionalizmi⁶.

Sot, në literaturën ndërkombëtare theksi vihet te dy modele kryesore të shtetndërtimit dhe administrimit territorial ndërkombëtar të OKB-të: në modelin formal të administrimit kalimtar dhe modelin informal të administrimit kalimtar⁷. Modeli informal supozohet të ketë një formë konsultative në angazhimin shtetndërtues tek institucionet vendase. Ndërsa modeli formal i administrimit territorial ndërkombëtar përfshin sot, në

⁵ David Chandler, "The State-Building Dilemma: Good Governance or Democratic Government", *Centre for the Study of Democracy University of Westminster*, Draft paper presented at Roundtable on Development, Under-Development and Armed Conflict Military Centre for Strategic Studies Rome, 25 October 2004, p.3 .<https://www.davidchandler.org/wp-content/uploads/2014/11/The-Statebuilding-Dilemma.pdf>

⁶ Po aty, 287.

⁷ Louise Andersen, "UN Peace Operations In the 21st Century: State-Building and Hybridity", *Danish Institute For International Studies*, Report 2007:11. p. 24

mënyrë eksplicite, marrjen e funksioneve të një qeverie (në rastin e Kosovës kishte ndodhur modeli formal i administrimit të OKB-së), në këtë model formal shtetëndertuesit e jashtëm - në këtë rast OKB-ja - kanë ushtruar autoritet të përkohshëm ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësor në Kosovë⁸. Pse ka ndodhur një administrim shtetëndertues kalimtar në Kosovë, autorë të ndryshëm e shpjegojnë me faktin se në Kosovë ka qenë një involvim i madh i vendeve kryesore evropiane si asistencë për misionin e përkohshëm të OKB-së (UNMIK), të cilat kishin ndihmuar në ndërtimin e institucioneve dhe demokratizimin e vendit, prandaj administrimi ishte kalimtar⁹.

Por, duhet potencuar faktin që në dekadat e fundit me administrimet territoriale të OKB-së po përdoret strategjia institucionalizimi para liberalizmit, pra ndërtimi i institucioneve stabile, përpara se shoqëritë postkonfliktuale të kenë të drejtë dhe një rol dhe përgjegjësi më të madhe në institucionet e tyre¹⁰. Një strategji të tillë të institucionalizimit para liberalizmit e favorizon edhe autori Roland Paris, ku sipas tij, është e domosdoshme që në shoqëritë postkonfliktuale së pari të ndërtohen institucione të forta për sundimin e ligjit dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, më pas të kalojnë përgjegjësitë tek institucionet dhe shoqëritë vendase postkonfliktuale¹¹.

Një strategji të tillë e ka përdorur edhe misioni i UNMIK-ut në Kosovë me rezolutën 1244. Roli dhe fushëveprimtaria e UNMIK-ut si mision në Kosovë ishte shoqëruar me shumë sfida, ndërsa baza legale ka qenë Karta e OKB-së dhe kapitulli VII, dhe vendosja e këtij misioni është cilësuar si ndërmarrja më e madhe në fushën e administrimit territorial ndërkombëtar¹². Në të gjitha rastet e administimeve të përkohshme ndërkombëtare, Këshilli i Sigurimit të OKB-së ka pasur rol të rëndësishëm në të gjitha aspektet, si të krijimit të misioneve, mbikëqyrjen, po ashtu edhe legjitimimin¹³.

Kështu, Bashkësia Ndërkombëtare në Kosovë fillimisht, si strategji legjitime, ka përdorur krijimin e një rendi politik me qëllim ndërtimin e institucioneve vetëqeverisëse demokratike përmes IPQV-ve. Pra, fillimisht

⁸ Andersen "UN Peace Operations", p, 25.

⁹ Po aty, 25.

¹⁰ Bashota, *Teoria dhe Praktika*, 291.

¹¹ David Chandler, "The State-Building Dilemma", p, 3.

¹² Halim Bajraktari, Roli dhe Prespektiva Europiane e Kosovës, punim doktore, Universiteti i Tiranës, (Tiranë:2014), 36.

¹³ Gëzim Selaci, *Legjitimiteti Politik në Kosovë: Rasti i Administratës së Përkohshme Ndërkombëtare*, (Artini, Prishtinë, 2020), 119.

është synuar krijimi i rendit kushtetues përmes të cilit do të ndërtoheshin institucione demokratike në shërbim të të gjithë qytetarëve të Kosovës më pas të bëhej bartja e kompetencave tek Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse të Kosovës, duke çuar drejt përcaktimit të statusit final¹⁴.

Për vendosjen e tyre, misionet ndërkombëtare të OKB-së gjithmonë kërkojnë që të legjitimoheshin dhe justifikoheshin edhe te popullata vendore ku vendosen. Ky është një fakt crucial për misionet ndërkombëtare: është me rëndësi legjitimiteti para se të merret një territor në administrim. Këtë, administrata e përkohshme e OKB-së në Kosovë e kishte arritur¹⁵.

Në rastin e Kosovës, OKB-ja ka artikuluar argumente të mjaftueshme, në pajtim me vlerat e përgjithshme të pranura në mbarë komunitetin ndërkombëtar, si dhe marrjen e autorizimeve nga Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së në mënyrë që PSSP-ja, si udhëheqës i administratës së përkohshme në Kosovë, të kishte legjitimitetin e plotë.

Legjitimiteti i PSSP-së është pranuar dhe vendosur për të plotësuar boshllëkun institucional në Kosovë në vitin 1999, një proces emergjent dhe i domosdoshëm pas shkatërrimeve të shkaktuara nga lufta. Përpjekjet e administratës së përkohshme të OKB-së në Kosovë (UNMIK), në përgjithësi, janë përqendruar për krijimin e paqes, stabilitetin politik, ndërtimin e institucioneve dhe promovimin e të drejtave njerëzore¹⁶.

Fillimet e frustrimeve ndaj administratës së përkohshme të OKB-së në Kosovë (UNMIK) në vitin 2004

Veprimtaria shtetndërtuese e misionit të përkohshëm të OKB-së (UNMIK) në Kosovë nga qarqet ndërkombëtare është vlerësuar si një nga misionet më ambicioze të OKB-së në shtetndërtim¹⁷. Marrja e përgjegjësisë për të ndërtuar një shoqëri në tërësi, siç ka vepruar OKB-ja në Kosovë, ka qenë një sfidë shumë e madhe për bashkësinë ndërkombëtare¹⁸. Sipas studiuesit *Ignatieff*, edhe pse nuk ishte përcaktuar saktë në Rezolutën 1244, qëllimi përfundimtar i misionit të përkohshëm të OKB-së (UNMIK) në Kosovë ishte shtetndërtimi,

¹⁴ Selaci, *Legjitimiteti Politik në Kosovë*, 17.

¹⁵ Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave, “Administrimi dhe Qeverisja në Kosovë”, *Seria për kërkime politike*, botim i veçantë, Prishtinë, Gjenevë, qershor 2005, 3.

¹⁶ Selaci, *Legjitimiteti Politik në Kosovë*, 99.

¹⁷ Dario Malnar, *SHBA-ja dhe Kosova*, (Prishtinë, 2013), 266.

¹⁸ Po aty, 266.

ku si bazë legale shërbente po kjo rezolutë¹⁹. Administrata e Përkohshme e OKB-së në Kosovë (UNMIK), gjatë viteve 2002 dhe 2003, pasi kishte arrestuar më shumë se gjashtëdhjetë ish-pjesëtarë të UÇK-së, u cilësua se ishin veprime politike. Ka mendime që kjo situatë kishte hapur mundësinë e një konfrontimi politik në javët e ardhshme me popullatën shqiptare²⁰. Gjithashtu, integrimi i serbëve në institucionet kosovare nuk ishte bërë sa duhet. Roli që luante Beogradi zyrtar kishte rritur guximin te popullata serbe që të mos integrohej, dhe administrata e UNMIK-ut nuk arriti, sidomos në pjesën veriore të Kosovës, ta ndërpriste kontrollin nacionalist serb dhe ndërhyrjen e vazhdueshme të Beogradit në punët e Kosovës²¹. Të gjitha këto që u cekën më lart ishin sinjal se gjërat mund të përkeqësoheshin në raportet e UNMIK-ut me vendorët.

Një artikull i botuar në revistën “*The Guardian*” nga autori Jon Henley, duke përshkruar situatën e përgjithshme në Kosovë katër vjet pas luftë, dha sinjale të hershme se gjërat nuk ishin ashtu siç do duhej të ishin. Sipas këtij artikulli, njerëzit kishin shpresuar më shumë në të gjitha aspektet, duke krijuar një mospërputhje mes asaj që ishte aktualisht dhe pritshmërive të tyre²².

Procesi i arrestimeve kishte filluar të lëkundë besueshmërinë e shqiptarëve ndaj UNMIK-ut dhe kishte ngjallur një valë protestash popullore kundër këtyre veprimeve. Ngjarjet e marsit llogariteshin të kishin filluar kur, në Çagllavicë, ishte raportuar se një serb ishte lënduar nga shqiptarët, siç pretendonte ai. Menjëherë të nesërmen, më 15 mars 2004, serbët, në shenjë proteste, kishin bllokuar rrugën kryesore. Në të njëjtën ditë, edhe veteranët e UÇK-së kishin protestuar kundër arrestimit të katër komandantëve të UÇK-së nga ana e UNMIK-ut. Për këto arrestime ishin organizuar protesta nga shoqatat e veteranëve të luftës së UÇK-së në Pejë dhe Prizren, ku bëhej thirrje që UNMIK-u të rishqyrtonte politikën e vet ndaj Kosovës dhe të lironte menjëherë luftëtarët e lirisë të arrestuar pa asnjë bazë ligjore²³.

¹⁹ Bashota, *Teoria dhe Praktika*, 293.

²⁰ Ian King & Whit Mason, *Paqe me çdo kusht: Si dështoi bashkësia ndërkombëtare në Kosovë*, Koha, Prishtinë 2007, 155.

²¹ James Pardew, *Paqebërësit: Liderhipi amerikan dhe fundi i gjenocidit në Ballkan*, Koha, (Prishtinë: 2021), 226.

²² Iain King, Whit Mason..., 147.

²³ Gazeta Epoka e Re, Prishtinë, 17 mars 2004 nr.1192.

Një nga pankartat dhe brohoritjet e protestuesve kishte qenë edhe ajo: “UNMIK mos u ngut, UÇK-ja të kallë barut”²⁴. Më 15 mars, mediat në këtë situatë tensioni, kishin raportuar edhe për mbytjen e tre fëmijëve shqiptarë në lumin Ibër, derisa ishin duke u ndjekur nga serbët²⁵. Gjërat u përkeqësuan shumë shpejt sa që situata pothuajse doli jashtë kontrollit. Menjëherë pas ngjarjeve të marsit dhe mbytjes së tre fëmijëve në fshatin Qabër, Ombudspersoni i Kosovës, Marek Antoni Nowicki, kishte paralajmëruar hetime rreth kësaj çështje. Për këtë ai ishte takuar me prokurorin ndërkombëtar, Peter Tinsley²⁶. Hetimet e mëpastajme, që ishin bërë për të vërtetuar rreth ndjekjes dhe mbytjes së fëmijëve shqiptarë në lumin Ibër, nuk kishin rezultuar me ndonjë dëshmi të besueshme se ata ishin ndjekur dhe mbytur nga serbët. Megjithatë, raportimi i shpejtë dhe i pakonfirmuar në media kishte bërë dëmin tashmë²⁷.

Si UNMIK-u, ashtu edhe KFOR-i mendohet se nuk kishin qenë të përgatitur sa duhet për një situatë që ishte zhvilluar shumë shpejt dhe zgjeruar po aq shpejt. Dhuna që kishte ndodhur në mars të vitit 2004 kishte shkaktuar tronditje të shumë akterë ndërkombëtarë. Javier Solana, Përfaqësuesi i Lartë i BE-së Për Politikë të Jashtme, pas një vizite në Prishtinë kishte fajësuar partitë politike shqiptare për dhunën e marsit 2004 të shkaktuar kundër serbëve. Ai shprehej se demonstratat nuk kishin qenë plotësisht spontane, por se kishte edhe grupe të organizuara që ishin të lidhura me partitë politike shqiptare; kjo sipas tij, ishte shumë e rrezikshme²⁸. Por Bajram Kosumi nga AAK nuk pajtohej me qëndrimet e Solanës dhe deklaronte se nëse Solana kishte informacione, duhej të ofronte argumente se demonstratat ishin të organizuara nga grupet e partive politike²⁹. Bajram Kosumi, gjatë një interviste që kam realizuar me të, deklaronte e gjithmonë kishte pasur një dozë të madhe skepticizmi që mosqartësimi nga bashkësia ndërkombëtare lidhur me drejtimin se kah do të shkonte Kosova kishte sjellë deri te demonstrimet, frustrimi nga popullata shqiptare dhe eskalimi i situatës në vitin 2004. Ndërkombëtarët nuk arritën të krijonin një vizion të qartë se ku do të ishte Kosova në një periudhë të caktuar. Ky, është faktori numër një që ka sjellë trazirat dhe frustrimet, megjithëse ai thotë që nuk pretendon të dijë të gjitha rrethanat dhe të vërtetën rreth

²⁴ Gazeta Epoka e Re, Prishtinë, 17 mars 2004, nr.1192.

²⁵ Tim Judah, Kosova: *Çfarë duhet të dijë secili*, (Prishtinë:2020),169.

²⁶ Gazeta Epoka e Re, Prishtinë, 24 mars 2004, nr.1198.

²⁷ Tim Judah, Kosova..., 171.

²⁸ Gazeta Zëri, Prishtinë, 26 mars 2004, nr.1298.

²⁹ Gazeta Epoka e Re, 27 mars, 2004, nr.1201.

trazirave të vitit 2004³⁰. Disa konsideronin se këto zhvillime kishin shpërfaqur dobësinë e pranisë ndërkombëtare në Kosovë, si pranisë civile, po ashtu edhe atë ushtarake. Diplomati amerikan Richard Holbrooke kishte deklaruar për agjencinë e lajmeve “Reuters” se gjatë një takimi që kishte pasur më herët, në tetorin e vitit 2003 në Prishtinë, me shefin e UNMIK-ut, Harri Holker, ia kishte tërhequr vërejtjen duke paralajmëruar se, nëse vazhdohej me politikën e shtyrjes së bisedimeve rreth statusit të Kosovës, mund të kishte fillime të eskalimit të situatës jo vetëm në Kosovë, por edhe në Ballkan³¹. Gjatë një interviste të zhvilluar, edhe profesori Arsim Bajrami deklaronte se politikat e UNMIK-ut deri tani kishin sjellë një paqe të brishtë, dhe mjaftonte një moment i vogël të ndodhte për të dalë nga situata jashtë kontrollit, dëmet që kishin ndodhur gjatë trazirave të marsit 2004 ishin të shumanshme dhe kolaterale. Por, profesori Arsim Bajrami mendonte se momenti pozitiv ishte që u tregua që status quo-ja ishte e rrezikshme për Kosovën, kështu që trazirat e vitit 2004 ishin sinjal se UNMIK-u duhej sa më parë të shkonte drejt realizimit të pikës 11 të detyrimit nga Rezoluta 1244, për definimin e statusit final të Kosovës³². Serbia, pas asaj që kishte ndodhur, kishte shpresuar se Perëndimi do të pranonte edhe ndarjen e Kosovës, dhe tashmë ishin krijuar kushtet për një veprim të tillë dhe tani ishte momenti³³. Por administrata e SHBA-së, duke parë se shpërthimi i dhunës në vitin 2004 ishte një tregues i ekzistencës së një potenciali të madh për konflikte ndëretnike, si në Kosovë po ashtu edhe në rajon, administrata e Bushit kishte dalë hapur në përkrahje të politikës që kishte shpallur PSSP-ja “Standardet Para statusit”³⁴.

Për këtë, administrata amerikane e presidentit Bush kishte angazhuar edhe më tepër Grupin e Kontaktit që të mbështeste politikën e UNMIK-ut për Standardet Para Statusit, ndërsa Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, duke parë zhvillimet tensionuese në Kosovë, menjëherë kishte vepruar duke emëruar ambasadorin norvegjez Kai Eide për të hartuar një raport për gjendjen në Kosovë³⁵. Përkushtimi i administratës amerikane ndaj të gjitha zhvillimeve që po ndodhnin në Kosovë gjatë vitit 2004 ishte edhe emërimi i personaliteteve mjaft të rëndësishme dhe që kishin përvojë me Ballkanin, si Filip Goldber,

³⁰ Intervistë me Bajram Kosumin, 04 prill 2024.

³¹ Gazeta Epoka e Re, Prishtinë, 25 mars 2004, nr.1199.

³² Intervistë me Arsim Bajramin, 03 prill 2024.

³³ Dario Malnar, *SHBA-ja dhe Kosova*, Koha, Prishtinë, 2013, 286.

³⁴ Po aty, 286.

³⁵ Po aty, 287.

Shef i Misionit Diplomatik të Zyrës Amerikane në Kosovë, po ashtu edhe Larry Rosin si Zëvendësshef i UNMIK-ut në Kosovë³⁶.

Nga raportet e ndryshme ndërkombëtare, trazirat e vitit 2004 ishin cilësuar si rrezikim shumë serioz i përpjekjeve të bashkësisë ndërkombëtare për një Kosovë multietnike. Gjithashtu, kishte konstatime që edhe policia e UNMIK-ut edhe SHPK-ja nuk kishin qenë në nivelin e detyrave dhe mandatit të tyre për të mbrojtur minoritetet gjatë trazirave të marsit³⁷. Gjatë një konference të përbashkët për shtyp të mbajtur nga UNMIK-u dhe KFOR-i, zëdhënësi i UNMIK-ut, Sunil Narula, kur ishte pyetur se kush ishin përgjegjësit për trazirat e marsit 2004, ishte përgjigjur se të gjithë jemi përgjegjës: edhe UNMIK-u, edhe KFOR-i, edhe institucionet e Kosovës, edhe qytetarët³⁸.

Mungesa e progresit rreth statusit final, si dhe mungesa e ndonjë indikacioni lidhur me atë se sa mund të zgjasë mandati i UNMIK-ut, ishin faktorë që ndikuan në shtimin e ndjenjës së frustrimit. Por ish-shefi i UNMIK-ut, Joachim Ruecker, gjatë një interviste që kam zhvilluar me të, deklaronte se trazirat që kishin ndodhur gjatë marsit të vitit 2004 nuk mund të justifikoheshin në asnjë mënyrë dhe se nuk kishin qenë faktorë që shpejtuan çështjen e hapjes së bisedimeve rreth statusit të Kosovës³⁹. Kishte konstatime se edhe UNMIK-u edhe KFOR-i nuk kishin qenë aq të përgatitur dhe nuk kishin ndërmarrë ndonjë preventivë para fillimit të trazirave të marsit 2004⁴⁰. Çdo veprim i ndërmarrë nga UNMIK-u, në veçanti marrëdhëniet e tij me Beogradin, janë vëzhguar me kujdes nga ana e shqiptarëve të Kosovës, për të gjykuar nëse një veprim i tillë ka avancuar njohjen e pavarësisë dhe zakonisht vëzhgimet e tilla kanë konkluduar se kjo nuk është bërë⁴¹.

Raporti i Grupit Ndërkombëtar të Krizave fajësonte edhe institucionet ndërkombëtare e posaçërisht UNMIK-un. Një raport nga organizata “*Human Rights Watch*”, vinte në pah se nuk ishte bërë siç duhej menaxhimi i rasteve në gjykata, për shqiptimin e dënimeve në mënyrë sa më efikase, ndaj atyre

³⁶ Po aty, 287.

³⁷ Human Rights Watch, “Failure to Protect: Anti-minority Violence in Kosovo”, March, 2004, report 25 July, 2004 <https://www.hrw.org/report/2004/07/25/failure-protect/anti-minority-violence-kosovo->.

³⁸ Gazeta Epoka e Re, Prishtinë, 25 mars 2004, nr.1199.

³⁹ Intervistë me ish-shefin e UNMIK-ut Joachim Ruecker 26.02.2024.

⁴⁰ Tim Judah, Kosova..., 170.

⁴¹ Raporti i ICG-së për Evropë, “Kolapsi Në Kosovë” 22 prill 2004, Prishtinë/Beograd/Bruks, https://www.files.ethz.ch/isn/28082/155_collapse_in_kosovo_albanian.pdf.

që kishin qenë pjesëmarrës në trazirat e marsit⁴². Gjithashtu, në raport përmendej se misioni i administratës së UNMIK-ut nuk ishte treguar edhe aq efikas në mbikëqyrjen e punës së gjykatësve vendorë rreth procesimit dhe trajtimit të lëndëve në mënyrë sa më efikase⁴³. Edhe një raport i dalë nga OSBE-ja potenconte se nuk kishte pasur efikasitet në trajtimin e rasteve nga gjykatat dhe kishte pasur vonesa në trajtimin e lëndëve, dhe se, sipas raportit, gjykatat shpeshherë kishin hasur në vështirësi për sigurimin e deklaratave nga dëshmitarët⁴⁴.

Sipas organizatës *Human Right Watch*, në vitin 2004 administrata ndërkombëtare kishte dështuar të siguronte drejtësi, edhe pse kishte premtuar një gjë të tillë, Kjo organizatë kishte bërë thirrje që UNMIK-u të pranonte faktin se sistemi i drejtësisë ishte në krizë dhe duhej punuar sa më shumë që agjenda për përmirësimin e sistemit të drejtësisë të ishte prioritet⁴⁵. Edhe pse duhet potencuar se në vitin 2004 një pjesë e madhe e kompetencave ishin bartur te Shërbimi Policor i Kosovës, policia ndërkombëtare e UNMIK-ut kishte kryesisht detyra këshilluese dhe monitoruese⁴⁶.

Rekomandimet për administratën e UNMIK-ut nga organizata "*Human Right Watch*" ishin që sa më parë të zhvillohej një plan veprues konkret, duke zhvilluar edhe programe të përbashkëta në mes vendorëve dhe ndërkombëtarëve për ngritje profesionale, po ashtu të gjyqtarëve dhe prokurorëve, rreth punës së përbashkët në mes vendorëve dhe ndërkombëtarëve⁴⁷. Trazirat e marsit 2004 ishin shpërthim nga i cili UNMIK-u dhe KFOR-i ishin frikësuar gjithnjë. Në një dokument që kishte dalë nga Zyra e Çështjeve Politike të OSBE-së, menjëherë pas trazirave, numëroheshin dhjetë faktorë që kishin krijuar kushtet për shpërthimin e trazirave dhe të dhunës: nacionalizmi i organizuar; ndjenja se Beogradi dhe bashkësia ndërkombëtare po e bllokoni përparimin e Kosovës drejt pavarësisë; frustrimi i rinisë, e arsimuar keq dhe e lënë pas dore;

⁴² Human Rights Watch, "Askund në agjendë dështimi i vazhdueshëm për të kërkuar përgjegjësi në Kosovë pas marsit 2004", raport nr 4, vëllimi 18, maj 2006, 7.

⁴³ Human Rights Watch, "Askund në agjendë dështimi i vazhdueshëm për të kërkuar përgjegjësi në Kosovë pas marsit 2004", raport nr 4, vëllimi 18, maj 2006, 3.

⁴⁴ OSCE Mission report, "Little progress in Kosovo justice system handling of March 2004 riot cases", <https://www.osce.org/kosovo/49880>, qasur me 29.02.2024

⁴⁵ Human Rights Watch, "Askund në agjendë dështimi i vazhdueshëm për të kërkuar përgjegjësi në Kosovë pas marsit 2004", raport nr 4, vëllimi 18, maj 2006, 3.

⁴⁶ Po aty, 10.

⁴⁷ Human Rights Watch, "Askund në agjendë dështimi i vazhdueshëm për të kërkuar përgjegjësi në Kosovë pas marsit 2004", raport nr 4, vëllimi 18, maj 2006, 5.

kriza e përkeqësuar ekonomike; mediat populiste dhe frymëzuese; mungesa e popullaritetit të UNMIK-ut, i cili fajësohej nga të gjithë për problemet e Kosovës; etj⁴⁸.

Ndonëse shumica e bashkësisë ndërkombëtare është përpjekur t'i shmangët ose të shtyjë për më vonë çështjen e statusit përfundimtar, mbajtja pezull e marrjes së vendimit po ashtu bart rreziqe ekonomike dhe shoqërore. Dykuptimësia e statusit përfundimtar të Kosovës është mjeti kryesor i frikësimit për tregti dhe investime⁴⁹. Kështu paraqitej situata gjatë vitit 2003, para trazirave të marsit 2004, sipas një hulumtimi të realizuar nga USAID në Kosovë. Ky hulumtim paralajmëronte se disa procese neglizhoheshin nga UNMIK-u dhe kjo mund të sillte një shpërthim eventual, me rreziqe dhe pasoja, si ekonomike, ashtu edhe politike.

Evitimi i situatës së rëndë politike gjatë vitit 2004

Pas trazirave të marsit të vitit 2004, situata e sigurisë dhe perceptimet ishin përmirësuar për pakicat. Janë tepër të rralla incidentet e dhunës ndëretnike, posaçërisht ndaj komunitetit serb⁵⁰. Kështu vlerësohej situata pas trazirave të marsit 2004 nga "*Fondacioni për Shoqëri Civile*". Ndërsa, raporti i të dërguarit special të SP të OKB-së në Kosovë, Kai Eide, qysh në gusht të vitit 2004 konkludoi se politika "*Standaret Para Statusit*" duhej ndryshuar drejt standardeve reale me statusin, hapja e bisedimeve për statusin e ardhshëm të Kosovës ishte vlerësuar si opsioni më i mirë dhe duhej të fillohej sa më parë⁵¹. Në këtë aspekt, edhe Grupi i Kontaktit kishte vlerësuar se kishte progres në Kosovë dhe se kishte shfaqur mbështetje për transferimin e kompetencave nga UNMIK-u te IPVQ-të⁵².

Për të sanuar dëmet e shkaktuara pas ngjarjeve të marsit, ishte formuar komisioni i përbërë nga ekipe të ekspertëve për vlerësimin teknik të dëmeve në 35 monumente dhe asambleve ortodokse. Komisionet ishin formuar nga

⁴⁸ Nijazi Halili, "Roli i diplomacisë shqiptare në zgjidhjen e krizes së Kosovës gjatë 2004-ës", <https://www.researchgate.net/publication/358276988>.

⁴⁹ Misioni i USAID-it Në Kosovë, "Plani Strategjik 2004-2008 Korrik, 2003", https://pdf.usaid.gov/pdf_docs/Pdabz154.pdf.

⁵⁰ KCSF, "Analiza_e_shoqerise_civile_ne_Kosove", marrë nga: https://www.kcsfoundation.org/wpcontent/uploads/2017/12/KCSF_2005pdf, Prishtinë, Kosovë Shtator 2005, 18

⁵¹ Dario Malnar, *SHBA-ja dhe Kosova...*, 287.

⁵² Po aty, 287.

ekspertët vendorë dhe ndërkombëtarë si Këshilli Evropës dhe Komisioni Evropian. Në mars 2005 ishte nënshkruar edhe një memorandum i mirëkuptimit nga Kisha Ortodokse Serbe dhe Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve, qëllimi i të cilit ishte themelimi i Komisionit Zbatues të Rindërtimit, për të rishikuar dhe menaxhuar procesin e rindërtimit të objekteve të dëmtuara⁵³.

Eksperti ndërkombëtar, i cili do të emërohej nga Këshilli i Evropës, Komisioni Evropian, ose nga ndonjë agjenci tjetër ndërkombëtare, do të udhëhiqte komisionin. Katër anëtarët tjerë do të jenë: përfaqësuesi i Kishës, përfaqësuesi i Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve në Beograd, përfaqësuesi i Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve të Kosovës, dhe përfaqësuesi nga MKRS-it. UNMIK-u do t'i ndihmojë komisionit si këshillëdhënës dhe do t'iu sigurojë asistencë teknike kurdo që është e nevojshme. Komisioni do t'i zbatojë rekomandimet e Këshillit të Evropës për punët e nevojshme gjatë verës dhe vjeshtës 2004. MKRS dhe KOS mund të sugjerojnë ndryshimet e veta në Këshillin e Evropës, të cilat do të shqyrtohen në takimin e parë të komisionit⁵⁴. Në shtator të vitit 2005, Komisioni Zbatues i Rindërtimit (RIC) u zotua se do të ishte në gjendje të shpenzonte 1.5 milion euro, nga 4.2 milionë të ndara për këtë qëllim nga buxheti i konsoliduar i Kosovës për vitin 2005. Nga Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse (IPVQ) kërkohen edhe 2.7 milionë, ndërsa Agjencia Evropiane e Rindërtimit (AER) kishte ndarë edhe 2 milionë për rindërtimin e objekteve fetare ortodokse⁵⁵.

Sa i përket kthimit të pakicave, situata shihej më pesimiste. Gjithashtu, potenciohej se besimi i humbur gjatë trazirave të vitit 2004 duhej rikthyer dhe rindërtuar. Duhet pasur parasysh se politizimi ishte i skajshëm për të gjitha zhvillimet në shoqërinë e Kosovës pas asaj që kishte ndodhur. Çështja e statusit final ishte dominuese në mendjen dhe imagjinatën e shoqërisë shqiptare në Kosovë. Me afrimin e fillimit të negociatave, ky preokupim kishte shënuar rritje në raport me çështjet e tjera urgjente⁵⁶. Dy ditë pas protestave të marsit 2004, Kofi Annan, Sekretar i Përgjithshëm i OKB-së, caktoi Kai Eiden ambasadorin e Norvegjisë në NATO, që të fillonte një mision rreth

⁵³ Qazim Namani, "Trashëgimia e kulturore historike në Kosovë gjatë shekujve XIX-XX-XXI", punim doktorarure, Universiteti i Tiranës, 2015, 107.

⁵⁴ Po aty, 122.

⁵⁵ Qazim Namani, Trashëgimia e kulturore historike në Kosovë gjatë shekujve XIX-XX-XXI, punim doktorarure, Universiteti i Tiranës, 2015, 8.

⁵⁶ KCSF, "Analizae shoqerise_civile në Kosovë".pdf, https://www.kcsfoundation.org/wpcontent/uploads/2017/12/KCSF2005Prishtinë_Kosovë_Shtator_2005, 18.

statusit final të Kosovës. Misioni i tij ishte të përcaktonte nëse kishte ardhur koha për të filluar bisedimet rreth statusit final të Kosovës⁵⁷. Pas vizitave në Kosovë dhe vlerësimit të situatës, ambasadori norvegjez Kai Eide përpiloi një raport prej rreth 14 faqesh, të cilin ia prezantoi Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Kofi Anan, raporti potenconte se implementimi i standardeve, që OKB-ja kishte filluar nga vitet 2002-2003, nuk ishte në nivelin e duhur. Kai Eide konkludonte se institucionet e Kosovës dhe ato ndërkombëtare duhej të ndërmerrnin masa urgjente për të përmirësuar situatën pas trazirave të marsit.

Gjithashtu, ai konkludonte, pas vëzhgimeve dhe takimeve në terren, se nuk kishte moment më të përshtatshëm për adresimin e statusit të ardhshëm të Kosovës sesa ai i tanishmi. Sipas tij, kishte ardhur koha që ky proces të fillonte, përkundër të gjitha vështirësive. Në raport, i cili daton në vitin 2005, konkludohej se duhej të niste lëvizja rreth statusit final të Kosovës⁵⁸. Në përgjigje ndaj këtij raporti, sekretari Kofi Annan i kishte kërkuar Martti Ahtisaarit që të fillonte mbikëqyrjen e këtyre bisedimeve që do të zhvilloheshin në Vjenë në vitin 2005. Tim Judah përmend në librin e tij “*Kosova: Çfarë duhet dijë secili*”, se Ahtisaari, privatisht, kishte pranuar se zgjidhja e vetme përpara për Kosovën do të ishte pavarësia⁵⁹. Një fakt të tillë e konfirmonte edhe ish-presidenti Fatmir Sejdiu gjatë takimeve që kishte pasur me të dërguarin e posaçëm nga sekretari i OKB-së për bisedime, presidentin Martti Ahtisaari⁶⁰. Pra, siç duket, trazirat e marsit 2004 kishin filluar të shpejtonin procesin e bisedimeve rreth statusit final të Kosovës. Kjo lidhej me frikën se situata mund të dilte jashtë kontrollit dhe se faktori ndërkombëtar do të paraqitej më i kujdesshëm ndaj bisedimeve midis Kosovës e Serbisë në të ardhmen.

Qëndrimet e faktorit politik ndërkombëtar rreth ngjarjeve të marsit të vitit 2004 në Kosovë

Për trazirat e marsit 2004 kritikant ish-in bashkëpunues të UNMIK-it dhe KFOR-it që nuk kishin bërë sa duhet. Edhe Human Rights Watch kishte kritikuar në këtë aspekt për neglizhencë të institucioneve ndërkombëtare, por Zëvendës shefi i UNMIK-it në atë kohë, Charles Brayshaw, kishte deklaruar gjatë një interviste të dhënë për *Koha Ditore*, duke i cilësuar si të tepruara

⁵⁷ Tim Judah, *Kosova-çfarë duhet të dijë secili*, (Prishtinë:2020),171.

⁵⁸ Po aty, 171.

⁵⁹ Tim Judah, *Kosova*, (Prishtinë:2020), 173.

⁶⁰ Intervistë me ish-presidentin Fatmir Sejdiu,11.09.2023.

këto kritika⁶¹. Për misionin e UNMIK-ut trazirat e marsit konsideroheshin mësimi i parë dhe ndërgjegjësimi, që ndërtimi i një paqeje të qëndrueshme do të ishte mision i vështirë⁶². Dy ishin shkaqet kryesore të theksuara që kontribuan në përmasën e trazirave të marsit: frustrimi i shoqërisë me kushtet e këqija ekonomike në Kosovë dhe frustrimi lidhur me mosvendimin rreth statusit të ardhshëm të Kosovës. Ndërsa, sipas Brayshaw, intervenimi politik kishte vënë trazirat nën kontroll⁶³. Ka pasur spekulime se gjithë kjo situatë edhe ka mundur të orkestrohej nga dikush, gjë që asnjëherë nuk u vërtetua⁶⁴. Në ballinën e gazetës *Koha Ditore* të 23 marsit 2004, Sekretari i NATO-s, Japp Hoop de Scheffer, kishte deklaruar se nuk besonte se statusi i pazgjidhur i Kosovës kishte sjellë deri te këto trazira. Gjithashtu, ai deklaronte se aktet kriminale nuk do të toleroheshin nga bashkësia ndërkombëtare⁶⁵. Ministri i jashtëm i Irlandës, në emër të presidencës së Bashkimit Evropian, kishte deklaruar se BE-ja ende kishte vizionin e një Kosove multietnike dhe demokratike, duke shtuar se ajo çfarë kishte ndodhur në trazirat e marsit nuk guxonte të përsëritej⁶⁶.

Havier Solana gjatë një interviste dhënë gazetës “*Koha Ditore*” më 24 mars 2004, kishte deklaruar se ishte mëkat që vetëm pesë vite pasi kosovarët ishin ndihmuar nga NATO-ja, të sulmonin ushtarët e saj⁶⁷. Në raportin zyrtar të misionit të UNMIK-ut, të publikuar pas trazirave, një pjesë të konsideruar të fajit ai e hedh në drejtim të medieve, të cilat i akuzon për nxitje të trazirave⁶⁸. Efekti grumbullues i këtyre incidenteve erdhi si rezultat i raportimit të dobët, të njëanshëm dhe nxitës mediatik. Demonstratat, të cilat në fillim dukeshin spontane, shpejt morën elemente të organizuara dhe grumbulluese; kështu i kishte cilësuar UNMIK-u trazirat e marsit 2004.

⁶¹ Agim Zogaj, “Pasqyra e shtypit të Kosovës.” *Deutsche Welle*, <https://www.dw.com/sq/pasqyra-e-shtypit-te-kosoves/a-2590807>, qasur me 07.02.2023.

⁶² Ibrahim Gashi, *Kosova: Rruga te Pavarësia*, (Prishtinë: 2012), 60.

⁶³ Agim Zogaj, “Pasqyra e shtypit të Kosovës.” *Deutsche Welle*, <https://www.dw.com/sq/pasqyra-e-shtypit-te-kosoves/a-2590807>, qasur me 07.02.2023.

⁶⁴ Arbreshë Info, “Krejt-cka-ndodhi-ne-trazirat-e-marsit-14-vjet-pas-askush-ska-pergjegje-si/” <https://www.arbresh.info/lajmet>, qasur me 07.02.2023.

⁶⁵ Lundrim Aliu, “Dhuna ishte orkestruar nga ekstremistët shqiptar”, *Gazeta Koha Ditore*, Prishtinë, 2004, nr. 2429.

⁶⁶ *Gazeta, Koha Ditore*, Prishtinë, 2004, nr. 2429.

⁶⁷ *Gazeta, Koha Ditore*, Prishtinë, 2004, nr. 2430.

⁶⁸ Muhamet Jahiri, “Analizë Kritike e Raportimit Të Gazetave Ditore Shqipe Për Trazirat e Marsit 2004”, Punim i Doktoratës, (Prishtinë:2018), 129.

Daniel Serwer, në një analizë të tij, kishte arritur në përfundimin se trazirat e marsit 2004 kishin dëmtuar rëndë procesin e Kosovës. Po ashtu, edhe Marton Abramowitz, anëtar ekzekutiv i Komitetit Ndërkombëtar të Krizave, kishte vlerësuar zhvillimet e vitit 2004 si më të këqijat që nga viti 1999 dhe si të tilla mund të rrezikonin edhe ndarjen e Kosovës. Abramowitz, në analizën e tij identifikon dy faktorë të cilët e kishin shkaktuar këtë situatë: faktori politik dhe grupi që ka organizuar trazirat dhe përplasjet ndëretnike. Dhuna që kishte ndodhur gjatë marsit 2004 kishte eksponuar dështimin e politikës perëndimore në Kosovë⁶⁹. Përmes një teksti të botuar në “Koha Ditore”, gazetari dhe aktivisti humanitar gjerman Rupert Nojdek u ishte drejtuar qytetarëve të Kosovës, duke theksuar se ajo që kishte ndodhur në trazirat e 17 dhe 18 marsit ishte një krim dhe një gabim shumë i madh, i ndërmarrë nga qytetarët shqiptarë të Kosovës⁷⁰. Në një sondazh të korrikut 2004, në një shfaqje të rrallë uniteti, shumica e qytetarëve të Kosovës – pavarësisht përkatësisë së tyre etnike (serbë, shqiptarë apo të tjerë) – ia atribuonin përgjegjësinë për situatën dhe krizën e marsit 2004 UNMIK-ut⁷¹. Duke u zhytur në paradoksin e tij të legjitimitetit dhe duke humbur luftën për zemrat dhe mendjet e popullit në Kosovë, dalëngadalë erdhi agjenda e shtetndërtimit të UNMIK-ut, për t'u parë si ekzogjene nga popullata vendase. U pagëzua nga vendasit si “UNMIKistan”⁷². Ka edhe mendime që trazirat ishin bërë shkak edhe për largimin e Shefit të UNMIK-ut, Harri Holker, nga misioni para kohe, në maj 2004, pa u mbushur as një vit nga ardhja e tij në Kosovë. Deklarimi zyrtar ishte se ai ishte larguar për shkaqe shëndetësore⁷³. Pas largimit të Harri Holker, praktika e të cilit ishte cilësuar si koloniale në raport me institucionet e përkohshme të Kosovës, në krye të UNMIK-ut erdhi Soren Jessen-Petersen danezi i cili cilësohej si një njohës i thellë i rajonit të Ballkanit. Kjo ishte cilësuar si një ndryshim dramatik në natyrën e misionit dhe në ushtrimin e mandatit të tij⁷⁴. Petersen, shefi i ri i UNMIK-

⁶⁹ Muhamet Jahiri, (Prishtinë:2018), 139.

⁷⁰ Po aty, 140.

⁷¹ Nicolas-Lemay-Hebert, “State-building from the Outside-In UNMIK and its Paradox” <https://www.researchgate.net/> qasur me 10.02.2023.

⁷² Nicolas-Lemay-Hebert, “State-building from the Outside-In UNMIK and its Paradox”, <https://www.researchgate.net/profile/> qasur me 10.02.2023.

⁷³ Bashkim Rrahmani, “Kosova nën protektoratin e OKB-së”, 101. <https://www.researchgate.net/profile/Bashkim-Rrahmani/publication/31691>, qasur 11.02.2023.

⁷⁴ Nicolas Lemay-Hebert, “State-Building from the Outside-In: UNMIK and Its Paradox”, 15. <https://jpia.princeton.edu/sites/g/files/toruqf1661/files/2009-4.pdf>.

ut, duke parë situatën menjëherë pas ardhjes, ndër konstatimet e tij të para kishte thënë se ekzistob një kufi se sa gjatë mund të mbahet një vend në gjendje kalimtare. Fundi i lojës dukej i vështirë, por në shkurt të vitit 2005, Petersen kishte deklaruar se kjo shoqëri ishte shumë e brishtë dhe se duhej shumë pak që të ndizejzjarri përsëri⁷⁵. Ndërsa, ish-emisari special për Ish-Jugosllavinë, Richard Holbrooke mendonte se politika e UNMIK-ut duhej reformuar sa më parë dhe se duhej të fillohej me hapjen e bisedimeve për statusin, sepse, sipas, tij shoqërisë së Kosovës duhej t'i jepej një perspektivë e qartë. Kjo pasiguri rreth statusit dhe lënia e çështjeve të hapura kishin qenë një pikë e dobët te shqiptarët, që kishte kontribuar edhe deri në shpërthimin e trazirave⁷⁶. Ky kishte qenë një mesazh i qartë për qendrat e vendimmarrjes, si dhe për Këshillin e Sigurimit.

⁷⁵ Ian King, Whit Mason, (Prishtinë:2007), 195.

⁷⁶ Erich Rathfelder, *Kosova: Historia e Një Konflikti*, Artini, (Prishtinë:2023), 296.

Bibliografi:

Monografi:

- Bashota, Bardhok. *Teoria dhe praktika e administrimit territorial ndërkombëtar*. Shkup, 2018.
- Judah, Tim. *Kosova: Çfarë duhet të dijë secili*. Prishtinë, 2020.
- King, Ian, dhe Whit Mason. *Paqe me çdo kusht: Si dështoi bashkësia ndërkombëtare në Kosovë*. Prishtinë: Koha, 2007.
- Malnar, Dario. *SHBA-ja dhe Kosova*. Prishtinë, 2013.
- Pardew, James. *Paqebërësit: Lidërshipi amerikan dhe fundi i gjenocidit në Ballkan*. Prishtinë: Koha, 2021.
- Rathfelder, Erich. *Kosova: Historia e një konflikti*. Prishtinë: Artini, 2023.
- Selaci, Gëzim. *Legjitimiteti politik në Kosovë: Rasti i Administratës së Përkohëshme Ndërkombëtare*. Prishtinë: Artini, 2020.

Punime dhe raporte institucionale:

- Andersen, Louise. “UN Peace Operations in the 21st Century: State-Building and Hybridity.” Danish Institute for International Studies, Report 2007:11.
- Chandler, David. “The State-Building Dilemma: Good Governance or Democratic Government.” Centre for the Study of Democracy, University of Westminster. Draft paper presented at the Roundtable on Development, Under-Development and Armed Conflict, Military Centre for Strategic Studies, Rome, 25 October 2004. <https://www.davidchandler.org/wp-content/uploads/2014/11/The-Statebuilding-Dilemma.pdf>.
- Human Rights Watch. *Askund në agjendë: Dështimi i vazhdueshëm për të kërkuar përgjegjësi në Kosovë pas marsit 2004*. Raport nr. 4, vëllimi 18, maj 2006.
- Human Rights Watch. *Failure to Protect: Anti-minority Violence in Kosovo*. Raport, 25 korrik 2004. <https://www.hrw.org/report/2004/07/25/failure-protect/anti-minority-violence-kosovo>.
- Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave. *Administrimi dhe qeverisja në Kosovë*. Seria për kërkime politike, botim i veçantë. Prishtinë–Gjenevë, qershor 2005.
- International Crisis Group. *Kolapsi në Kosovë*. Raport i ICG-së për Evropë, 22 prill 2004. Prishtinë/Beograd/Bruksel. https://www.files.ethz.ch/isn/28082/155_collapse_in_kosovo_albanian.pdf.
- KCSF. *Analiza e shoqërisë civile në Kosovë*. Prishtinë, Kosovë, shtator 2005. https://www.kcsfoundation.org/wp-content/uploads/2017/12/KCSF_2005.pdf.
- Misioni i USAID-it në Kosovë. *Plani strategjik 2004–2008*. Korrik 2003.

- https://pdf.usaid.gov/pdf_docs/Pdabz154.pdf.
- OSCE Mission Report. “Little progress in Kosovo justice system handling of March 2004 riot cases.”
<https://www.osce.org/kosovo/49880> (qasur më 29 shkurt 2024).
- Whaites, Alan. “States in Development: Understanding State-building–Governance and Social Development.” Group Policy and Research Division, A DFID Working Paper, 2008.
<https://gsdrc.org/document-library/states-in-development-understand> (qasur më 25.12.2023).

Dokumente institucionale (burime primare):

- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve e Kosovës. *Memorandum of Understanding on Agreed General Principles for the Reconstruction of Churches*. Dokument zyrtar institucional, Prishtinë, 2004.

Disertacione:

- Bajraktari, Halim. *Roli dhe prespektiva europiane e Kosovës*. Tezë doktrature, Universiteti i Tiranës, Tiranë, 2014.
- Jahiri, Muhamet. *Analizë kritike e raportimit të gazetave ditore shqipe për trazirat e marsit 2004*. Punim doktrature, Prishtinë, 2018.
- Namani, Qazim. *Trashëgimia kulturore-historike në Kosovë gjatë shekujve XIX–XX–XXI*. Tezë doktrature, Universiteti i Tiranës, 2015.

Artikuj / publikime online:

- Halili, Nijazi. “Roli i diplomacisë shqiptare në zgjidhjen e krizës së Kosovës gjatë 2004-ës.” Qasur më 15 qershor 2022.
<https://www.researchgate.net/publication/358276988>
- Rrahmani, Bashkim. *Kosova nën protektoratin e OKB-së*. Qasur më 11 shkurt 2023.
https://www.researchgate.net/publication/316919306_Kosova_nen_protectoriatin_e_OKB-se
- Zogaj, Agim. “Pasqyraeshtypitë Kosovës.” *Deutsche Welle*. Qasur më 7 shkurt 2023.
<https://www.dw.com/sq/pasqyra-e-shtypit-te-kosoves/a-2590807>
- Arbresh Info. “Krejt çka ndodhi në trazirat e marsit – 14 vjet pas, askush s’ka përgjegjësi.” *Arbresh.info*. Qasur më 7 shkurt 2023.
<https://www.arbresh.info/lajmet/krejt-cka-ndodhi-ne-trazirat-e-marsit-14-vjet-pas-askush-ska-pergjegjesi/>

Gazetat:

- *Epoka e Re*. Prishtinë, 2004.
- *Zëri*. Prishtinë, 2004.
- *Koha Ditore*, 2004.

Intervistat:

- Intervistë me Arsim Bajramin, profesor universitar, 3 prill 2024.
- Intervistë me Bajram Kosumin, ish-kryeministër i Kosovës, 4 prill 2024.
- Intervistë me Fatmir Sejdiu, ish-president i Republikës së Kosovës, 11 shtator 2023.
- Intervistë me Joachim Ruecker, ish-shef i UNMIK-ut, 26 shkurt 2024.

Behxhet DIBRANI

University of Pristina-Faculty of Philosophy

The Department of History

Email: bdibrani@hotmail.com

ORCID: <https://orcid.org/0009-0006-9301-9596>

KUD: 94(496.51)"2004"(05)

&

Arben BERISHA

University of Pristina-Faculty of Philosophy

The Department of History

Email: arben.berisha9@student.uni-pr.edu

ORCID: <https://orcid.org/0009-0002-5754-6736>

KUD: 94(496.51)"2004"(05)

SUMMARY**THE 2004 UNREST IN KOSOVO: THEIR IMPACT ON THE INITIATION OF NEGOTIATIONS ON KOSOVO'S STATUS**

In conclusion, it can be concluded based on the consultation of documents, reports and literature that the riots of March 2004 in Kosovo occurred as a result of a situation that was not well understood by the international community. After the riots, the approach of the UN interim international administration in Kosovo began to change, and the international community also understood that it was wrong to neglect to open the beginning of talks on the future status of Kosovo. The fear that had gripped the people of Kosovo about the future of Kosovo was clearly seen with the beginning of the riots of March 2004.

The damage from these riots was quite large, both in people and material damage, and Kosovo's reputation in the international arena was also damaged considerably. For all this, the Albanians could not be blamed alone, but it was found that part of the blame also lies with the UN interim international administration in Kosovo, as well as KFOR, both of these institutions were found to be unprepared for a faster and more adequate reaction.

The lack of a clear perspective for the future of Kosovo turned out to be one of the key factors that led to the violent demonstrations, this was also concluded by many international diplomats, this caused even the UN

Secretary General Kofi Annan to send the special representative Kai Eide to prepare a detailed report on the situation in Kosovo. Kai Eide's report also presented the real situation in Kosovo in 2004 and the final recommendations were to immediately begin preparations for the start of negotiations on the status of Kosovo.

It should also be noted that after Kai Eide's report, the policy of the UN interim administration in Kosovo began to change, from now on the standards would continue to run in parallel with the start of talks on the status of Kosovo. While until now the UN interim administration UNMIK in Kosovo had declared that the standards in Kosovo should first be met and then talks on the future status of Kosovo would begin, this strategy turned out to be wrong and did not bring satisfactory results. This conclusion was confirmed by many international diplomats as well as credible international institutions. Therefore, upon his arrival, the UN Secretary-General's special representative in Kosovo, the Danish Soren Jessen Petersen, declared that the people of Kosovo must know about their future and that everything has a limit and that they must immediately work hard and not allow a situation like the riots of March 2004 to be repeated.